

ILLYRIA ORGANIZON PROJEKTIN E PRAKTIKAVE NË KOSOVË

Projekti:

Gjendja në Kosovë: Për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e një demokracie të qëndrueshme, Kosova ka nevojë jo vetëm për mbështetje ekonomike nga jashtë, por edhe për kontributin e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Një mundësi të tillë ofron: Unioni i Studentëve Shqiptarë „Illyria“, në bashkëpunim me Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale në Kosovë.

PRAKTIKA NË KOSOVË

Praktikat dhe Qëllimi: Në përendim ka pothuajse në çdo univerzitet studentë shqiptarë, në drejtime të ndryshme. Këta studentë mund të jenë një ndihmë e madhe për zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Me një praktikë në Kosovë studentët do ta njohin ndërtimin, strukturat organizative, detyrat dhe ecurinë e punës në institucionet e Kosovës. Studentëve duhet t'iu mundësohet njohja me mardhënjet e punës në Kosovë, për të fituar një përshtypje se në çfarë mënyre ata mund të kontribuojnë me eksperiencën e fituar në përendim ose jashtë Kosovës.

Ecuria e praktikës: Praktikat do të zhvillohen në institucionet shtetërore të Kosovës si p.sh. ministritë, parlament dhe institucione të tjera shtetërore, si dhe në organizata joqeveritare, në kompani shoqërore ose private, nëse ato ofrojnë vende praktikash.

Shumica e vendeve të praktikave ofrohen gjatë kohës së pushimeve verore. Ne nuk mund të përcaktojmë ndonjë datë për fillimin e praktikës, pasi që në univerzitetet dhe fakultetet e ndryshme pushimet janë jo në të njëjtën kohë. (* nuk përjashtohet mundësia që realizimi të bëhet edhe gjatë semestrit)

Rreth kohëzgjatjes së praktikës marrëveshja bëhet me ofruesin së njëjtës. Në përgjithësi kjo është 4 - 6 javë.

Praktikantët do të marrin në fund të praktikës një çertifikatë nga vendet përgjegjëse.

Kushtet për pjesëmarrje në praktika: Studentët duhet të kenë prejardhje kosovare, pa marrë parasyshë përkatësinë etnike apo fetare. Pra janë të mirëseardhur edhe studentët e nacionaliteteve të tjera të cilët dëshirojnë të ndikojnë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e demokracisë dhe ardhmerisë së Kosovës. Studentët duhet të kenë njohuri themelore në drejtimin e tyre d.m.th. të kenë studimin bazë që ata të mund të përfitojnë sa më shumë gjatë praktikave. Aplikimi për praktika bëhet tek Unioni i Studentëve Shqiptarë „Illyria“. në Hamburg

Organizimi dhe Aplikimi: Projekti i lartpërmendur organizohet nga Illyria, nga Hajrullah Ahmeti dhe Shukri Orani, në bashkëpunim me ministrinë e punës dhe çështje sociale në Kosovë, i ngarkuari në Prishtinë/Kosovë: Julius Krause, Senior expert department of labour and employment. [I tërë Projekti është afatgjatë, d.m.th praktikat do të bëhen për cdo vit.](#)

Aplikimi: [Aplikimi bëhet „online“.](#)

Dokumentet për aplikim dërgohen në këtë adresë interneti:

prak.kosova@gmx.de

Para aplikimit ju lutemi lexoni informacionet për vendet e praktikave!

[Çfarë duhet të jëtë të aplikimi?](#)

I. Një letër aplikimi (Nga kjo letër duhet të theksohet dëshira për vendin dhe kohën e mbajtjes së praktikës.)

2. Biografia: Biografia duhet të përmbajë: Emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, ecurinë e shkollimit (p.sh. gjimnaz etj.), drejtimi dhe vendi i studimit, përvojat në profesion (p.sh. praktika, punë etj.), gjuhë të huaja dhe informata tjera eventuale...

Vendet e praktikave: Praktika tek GTZ-ja gjeramane (Gesellschaft für technische Zusammenarbeit - Shoqëria për bashkëpunim teknik)
GTZ-ja vepron në Kosovë në fusha sociale: shkollim dhe edukim.
Prandaj studentët që konkurojnë për një vend praktike te GTZ-ja duhet të kenë drejtimet në shkencat sociale p.sh. Pedagogji, Psikologji, Sociologji etj..
[Praktika tek GTZ-ja zgjatë 2 - 6 muaj.](#)

Praktika te ministritë: Praktikant mund të bëhen në të gjitha ministritë kosovare.
Ministritë ofrojnë praktika për të gjitha drejtimet.
Studentët duhet të theksojnë dëshirën se në cilin ministri ata dëshirojnë të bëjnë praktikën.

Ministritë në të cilat mund të realizohen praktikant:

- Ministria e Tregëtisë dhe e Industrisë**
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale**
- Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe e Çështjeve Jorezidente**
- Ministria e Energjisë dhe Minierave**
- Ministria e Shëndetësisë**
- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave**
- Ministria e Shërbimeve Publike**
- Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit**
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**
- Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor**
- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale**
- Ministria për Komunitete dhe Kthime**

Praktika në spitalin e Skënderajt: Në spitalin e Skënderajt ofrohen këto shërbime mjekësore në të cilat mund të bëhet edhe praktika:

Station: Gjinekologjia,
Ambulantë: Pediatria , mjekësia interne,
Rëntgeni dhe Labori.
Këtu mund të shihet se si kontrollohen dhe terapohen pacientët edhe pa paisje të mëdha dhe moderne.
Maksimum 2 studentë mund të apsollojnë praktikë në të njejtën kohë.
Zgjatja e praktikave sipas dëshirës së studentëve.

Stafi i projektit: Nga Illyria: Hajrullah Ahmeti dhe Shukri Orani
Nga ministria per punë dhe çështje sociale: Julius Krause
Për informata në: www.illyria.de ose e-mail në: prak.kosova@gmx.de